

VENDIM
Nr. 490, datë 30.7.2021

PËR KRYERJEN E PAGESËS SË DOZAVE TË VAKSINAVE DHE TË PAGESAVE RESPEKTIVE, QË RRJEDHIN NGA MARRËVESHJA E NËNSHKRUAR PËR PRODHIMIN DHE FURNIZIMIN, NDËRMJET *PFIZER EXPORT B.V.* DHE MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, MINISTRIT TË SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE INSTITUTIT TË SHËNDETIT PUBLIK, TË MIRATUAR ME AKTIN NORMATIV NR. 3, DATË 18.1.2021, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, DHE ME LIGJIN NR. 3/2021

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të nenit 14, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, të aktit normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik”, të miratuar me ligjin nr. 3/2021, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe të ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kryerjen nga Instituti i Shëndetit Publik të pagesave, të përcaktuara në marrëveshjen e nënshkruar për prodhimin dhe furnizimin ndërmjet *Pfizer Export B.V.* dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrit të Shtetit për Rindërtimin dhe Institutit të Shëndetit Publik, të miratuar me aktin normativ nr. 3, datë 18.1.2021, të Këshillit të Ministrave, dhe me ligjin nr. 3/2021, në vlerën 2 447 233.68 (dy milionë e katërqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e tetë) euro, të konvertuara sipas kursit zyrtar të këmbimit në ditën e pagesës.

2. Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, në buxhetin e saj të miratuar për vitin 2021, në llogarinë ekonomike 6050000 (produkti 91305AH) të programit “Shërbime të shëndetit publik” (07450), i shtohet ekuivalenti në lekë i shumës prej 2 447 233.68 (dy milionë e katërqind e dyzet e shtatë mijë e dyqind e tridhjetë e tre pikë gjashtëdhjetë e tetë) euro, për kryerjen e pagesës së dozës së vaksinës nga kompania *Pfizer Export B.V.*

3. Fondi, sipas pikës 2, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2021.

4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Instituti i Shëndetit Publik për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe